

Promovimi i botimeve, 31.05.2017

Kolegë dhe miq të nderuar,
Zonja dhe zotërinj,
Media të nderuara,

Sot do të bëjmë promovimin e 40 botimeve origjinale të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës nga fusha të ndryshme: nga shkencat albanologjike, shkencat shoqërore, kulturo-historike, shkencat e natyrës, gjeoshkencat, shkencat e mjedisit dhe publikimet nga sfera e arteve të realizuara brenda harkut kohor prej më pak se dy vjetëve. Përkundër problemeve të përhershme financiare dhe disa shkurtimeve shtesë që erdhën nga Qeveria për të gjitha zërat financiarë në Kosovë këto kohët e fundit, mund të konstatojmë se me një ekonomizim dhe racionalizim të kujdesshëm të mjeteve Akademia ka arritur ta realizojë këtë objektiv themelor të saj.

Përveç këtyre botimeve, Seksionet dhe trupat e tjera të Akademisë, me bashkëpunëtorë të jashtëm, punuan në disa projekte shkencore-hulumtuese, në projekte enciklopedike-shkencore - afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, mbajtën shumë tryeza e konferenca shkencore dhe zhvilluan aktivitete të tjera shkencore dhe artistike (koncerte, ekspozita) dhe realizuan mjaft kontakte ndërkombëtare, përfshirë dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me akademitë simotra evropiane, si p. sh. me Akademinë e Mbishkrimeve dhe të Letërsisë të Francës (Académie des Inscriptions et Belle Lettres).

Para se t'ua jap fjalën sekretarëve të seksioneve që t'i prezantojnë shkurtimisht botimet e 4 seksioneve, me dy-tri fjalë po i prezantoj botimet e Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Botimi 40-vjetori i ASHAK-ut përmban historikun e Akademisë, të gjitha fazat e veprimtarisë së saj, me ngritjet dhe rëniet, të ndërlidhura me zhvillimet e përgjithshme shoqërore dhe politike të Kosovës. Janë edhe 3 vjetarë, që secili tregon frymimin e jetës njëvjeçare të Akademisë, me të gjitha informacionet, si dhe Fjalësi shqip i lematizuar i fjalorit serbokroatisht-shqip i Sokol Dobroshit të vitit 1953, si pjesë e projektit "Shqipja e shekullit XX", që mëton të përfshijë korpusin e shqipes së shkruar gjatë këtij shekulli.

Tash shkojmë me radhë: nisim me botimet e Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, të Seksionit të Shkencave Shoqërore, të Shkencave të Natyrës dhe të Arteve. Fjalën e kanë sekretarët: Eqrem Basha, Jusuf Bajraktari, Fejzullah Krasniqi dhe Luan Mulliqi.